



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO
GJYKATA THEMELORE MITROVICË

Numri i lëndës: 2024:061329

Datë: 26.03.2024

Numri i dokumentit: 05506688

PPP.nr.17/2024

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË, Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil, me gjyqtar Genc Hasani dhe më bashkëpunëtoren profesionale Valbona Berisha –Tahiri, duke vendosur në çështjen përmbartimore të kreditorit SH.A. KUR “Mitrovica” J.S.C., me numër fiskal 600338033, adresa: rruga “Bislim Bajgora” p.n., Mitrovicë kundër debitorit E.M., lidhur me pagesën e borxhit, vlera e kontestit 1610.88€, duke vendosur për kërkesën për kthimin në gjendjen e mëparshme të parashtruar nga debitori me dt. 09.02.2024, jashtë seancës në datën 26.03.2024 nxori këtë:

A K T V E N D I M

I. HEDHET POSHTË propozimi mbi kthimin në gjendjen e mëparshme, i parashtruar nga ana e debitorit E. M. nga M., të parashtruar nga debitori i datës 09.02.2024, kundër urdhrin përmbartimorë P.nr. 912/2018 te dt. 08.03.2018, sipas propozimit të kreditorit SH.A. KUR “Mitrovica” J.S.C., me numër fiskal 600338033, adresa: rruga “Bislim Bajgora” p.n., Mitrovicë si i PA AFATSHËM.

A r s y e t i m

Përmbartuesi Privat Atip Mustafa, duke vepruar sipas propozimit të kreditorit SH.A. KUR “Mitrovica” J.S.C., me numër fiskal 600338033, adresa: rruga “Bislim Bajgora” p.n., Mitrovicë, me datë 03.03.2021 ka lëshuar Urdhrin përmbartimor P.nr. ..., me të cilin ka lejuar përmbartimin në bazë të dokumentit të besueshëm, përkatësisht kartelës financiare të konsumatorit Code:008312, të datës 08.03.2018, në emër të debitorit E. M. – M., për shfrytëzimin e ujësjellësit dhe shërbimeve të kanalizimit, me të cilin ka kërkuar që të detyrohet debitori që kreditorit t’ia paguaj borxhin në shumën (1610.88€), së bashku me kamatën ligjore prej 8%, nga data e paraqitjes së propozimit e deri në pagesën definitive, si dhe shpenzimet e procedurës përmbartimore, të gjitha këto në afat prej 7 ditësh nga dita e pranimit të këtij urdhri, në të kundërtën, të bllokohen llogaritë bankare të debitorit ose të bëhet regjistrimi dhe sekuestrimi i sendeve të luajtshme dhe të paluajtshme.

Pas lejimit të përmbartimit, propozimi se bashku me urdhër përmbartimor dhe me shkresa përcjellëse ju ka ekspeduar debitorit me dt. ..., ku nga flet kthesa konstatohet data dhe nënshkrimi.

Debitori me dt... ka paraqitur propozimin mbi kthimin në gjendjen e mëparshme, me arsyetimin se propozimin nuk e kame pranuar unë por e ka pranuar dikush tjetër, andaj ka kërkuar nga gjykata që të mundësohet paraqitja e prapësimit duke shtuar se kërkesën e mbështetës në Ligjin për Procedurën Kontestimore me nenin 130 par.2 dhe par 3. Si dhe neni 62 pika 2 Ligji për Procedurën Përmbartimore në fuqi.

Gjykata vlerësoj se vendosja e kësaj çështje juridike përmbartimore si në pikën I të dispozitiv të aktvendimit sa i përket hedhjes poshtë si të pa afatshme të kërkesës për kthim në gjendjen e mëparshme gjen mbështetje ligjore në dispozita e Ligjit të Procedurës Kontestimore si dhe Ligjit të Procedurës Përmbartimore.

Nenin 110 par.1 të LPK-së flet për dorëzimin e shkresave personale i cili thotë citoi “Padi, përgjigjja në padi, letërthirrja për në seancë, urdhërpagesa, aktgjykimi dhe aktvendimi, kundër të cilit lejohet ankim i veçantë, mjeti i goditjes së vendimit, i dorëzohet personalisht palës, gjegjësisht përfaqësuesit ligjor apo përfaqësuesit me prokurë të saj. Shkresat e tjera do t’i dorëzohen personalisht adresatit kur një gjë e këitillë shprehimisht parashihet me këtë ligj apo kur gjykata konkludon se për shkak të dokumenteve origjinale që i anë bashkangjitur shkresës që duhet dorëzuar, ose nga ndonjë shkak tjetër, nevojitet kujdes i shtuar”, kurse neni 112 i LPK-së parasheh se “Kur personi të cilit i është dërguar shkresa, përkatësisht anëtari i rritur i familjes së tij, përkatësisht personi i autorizuar ose i punësuar në organin shtetëror apo në personin juridik, pa ndonjë arsye të ligjshme refuzon ta marrë në dorëzim shkresën, dorëzuesi do t’ia lejë në banesë ose në lokalet në të cilat punon personi i tillë apo do t’ia bashkëngjis shkresën në derën e banesës apo lokalit të punës. Në fletë dërgesë do të shënohet dita, ora dhe shkaku i refuzimit të marrjes si dhe vendi ku është lënë shkresa. Komunikimi i kryer në këtë mënyrë quhet i ligjshëm”.

Ndërsa neni 130. par.2 të LPK-së thotë citoi “Propozimi duhet të paraqitet brenda afatit shtatë (7) ditë nga dita kur ka pushuar shkaku i mosveprimit, e po që se pala më vonë ka mësuar për mosveprimin, atëherë afati llogaritet nga dita kur ka mësuar për mosveprimin”, ndërsa neni 130.3 thotë citoi “Pas kalimit të gjashtëdhjetë (60) ditëve nga dita e mosveprimit nuk mund të kërkohe kthimi në gjendjen e mëparshme”

Gjithashtu neni 68 par.2 të LPP-së parasheh se “Kthimi në gjendjen e mëparshme është i lejuar vetëm në rastet e mos ruajtjes së afateve për paraqitjen e prapësimit dhe ankesës kundër vendimeve të përmbartueshëm për përmbartimin me dhunë”.

Gjykata Themelore në Mitrovicë, si përmbartimore në zbatim të dispozitave të lartcekura, vlerësoi propozimin e debitorit dhe gjeti se i njëjti është i pa afatshëm, ngase në bazë të shkresave të cilat gjinden në lëndë gjegjësisht nga fletë kthesa vërtetohet se propozimin për përmbartim e të lejuar me urdhër përmbartimor, me dt. është pranuar ku shihet data dhe nënshkrimi ku përmes tije debitori E. M. ka parashtruar propozimin për kthimin në gjendjen e mëparshme kurse i njëjti nuk ka shfrytëzuar të drejtën për të parashtruar mjetin juridik ndaj aktvendimit mbi lejimin e përmbartimit.

Ne baze te nenit 319 te LPK-së ku shprehimisht thuhet “ Secila nga palët ndërgjyqëse ka për detyre te provoje faktet mbi te cilat i bazon kërkimet dhe pretendimet e veta” ne rastin konkret edhe pse debitori nuk e ka pranuar personalisht propozimin për përmbarim, propozimi për kthimin ne gjendjen e mëparshme është paraqitur me datën 09.03.2024 e nga data e pranimit te propozimit 12.03.2018 deri tek data e paraqitjes se propozimit për kthimin ne gjendjen e mëparshme kane kaluara afër gjashte vite. Ne rastin konkret dispozitat e LPK-së janë shume te qarta ne lidhje me afatin e paraqitjes se propozimit për kthimin ne gjendjen e mëparshme ku afati maksimal për paraqitjen e te njëjti është 60 dite. Andaj gjykata nuk kishte si te vendoste ndryshe si ne piken I te këtij dispozitivi.

Gjykata konform nenit 17 te LPP-së përshtatshmërisht aplikoj dispozita ligjore te LPK-së

Andaj, nga të lartcekurat e duke u bazuar në nenin 3, 17, 68 par.2, 69, 71, dhe 73.3 të LPP-së (Ligjit të Procedurës Përmbarimore), e ne lidhje me nenin 110, 112 dhe 130 par. 2 dhe 3, 319 të LPK-së, gjykata vendosi si në pikën I dhe II te dispozitivit të këtij Aktvendimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË
Departamenti i Përgjithshëm-Divizioni Civil
PPP.nr.17/2024, datës 26.03.2024

G J Y Q T A R I,
Genc Hasani

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij Aktvendimi nuk është e lejuar e drejta në Ankesë, duke u bazuar në dispozitën e nenit 133 par.4, të LPK-së.